

SHËNIME METODOLOGJIKE MBI TREGUESIT E SHËNDETIT FINANCIAR

TREGUESIT KRYESORË PËR BANKAT

Bankat luajnë një rol qendror në sistemet financiare. Gjendja e tyre financiare dhe elasticiteti ndaj goditjeve është i një rëndësie të veçantë për stabilitetin financiar. Treguesit kryesorë për sektorin bankar përfshijnë raportet më kyçe lidhur me situatën financiare të sektorit.

MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT

I001: Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezikun. Ky tregues mat raportin e kapitalit rregullator për të gjitha pozicionet e peshuara me rrezikun në përputhje me parimet e Bazelit për kërkesat për kapital. Ai llogaritet në bazë të raportimeve individuale të bankave në përputhje dhe për zbatim të rregullores nr. 48/2013 “Mbi mjaftueshmërinë e kapitalit”, e ndryshuar, e cila përaftron plotësisht përcaktimet e Marrëveshjes së Bazeli II, si dhe rregullores nr. 69/2014 “Mbi kapitalin rregullator”, e ndryshuar, në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes së Bazeli III. Treguesi është i disponueshëm vetëm në frekuencë tremujore dhe korrespondon me treguesin gjerësisht të përdorur – “mjaftueshmëria e kapitalit”.

I002: Kapitali bazë ndaj aktiveve të peshuara me rrezikun. Ky tregues mat raportin e kapitalit bazë (Tier 1) për të gjitha pozicionet e peshuara me rrezikun. Ai llogaritet në bazë të raportimeve individuale të bankave në përputhje dhe për zbatim të rregullores nr. 48/2013 “Mbi mjaftueshmërinë e kapitalit”, e ndryshuar, e cila përaftron plotësisht përcaktimet e Marrëveshjes së Bazeli II, si dhe rregullores nr. 69/2014 “Mbi kapitalin rregullator”, e ndryshuar, në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes së Bazeli III. Treguesi është i disponueshëm vetëm në frekuencë tremujore dhe korrespondon me treguesin gjerësisht të përdorur – “Raporti i modifikuar i mjaftueshmërisë së kapitalit”.

I003: Kredi me probleme neto ndaj kapitalit. Raporti synon të evidentojë ndikimin e mundshëm në kapital të kredive me probleme neto dhe siguron një tregues të kapacitetit të kapitalit të bankës për të përballuar humbjet nga aktiviteti kreditues. Ky tregues llogaritet duke vënë në raport vlerën e kredive me probleme, të netuar për vlerën e rezervave të provigjionimit për kreditë, ndaj kapitalit aksionar, shprehur në përqindje. Kreditë me probleme përfshijnë klasat “nënstandarde”, “të dyshimta” dhe “të humbura” të përcaktuara në rregulloren nr. 62/2011 “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, e ndryshuar. Llogaritja e këtij treguesi është gjerësisht në përputhje me metodologjinë e FMN-së, ku si kriter për përcaktimin e kredisë si “kredi me probleme”, nuk është vetëm numri i ditëve në vonesë (90 ditë), por edhe gjendja financiare e huamarrësit. Përpos, kredia me probleme nuk përfshin kreditë ndaj bankave qendrore dhe aktivet afatgjata të mbajtura për shitje, por gjithsesi ndikimi në vlerën e treguesit konsiderohet i papërfillshëm. Treguesi përdoret në analizat e Bankës së Shqipërisë dhe është i lidhur me dy tregues të tjerë të të njëjtës natyrë: “Hua me probleme neto ndaj kapitalit bazë” dhe “Hua me probleme neto ndaj kapitalit rregullator”.



CILËSIA E AKTIVEVE

1004 Kredi me probleme ndaj totalit të kredive. Ky tregues paraqet raportin e kredive me probleme ndaj vlerës totale të kredisë (totali i kredisë përfshin tepicën e kredive me probleme pa zbritur vlerën e provigjionit për kredinë) dhe mund të përdoret për të zbuluar problemet e likuiditetit. Kreditë me probleme janë klasat “nënstandarde”, “të dyshimta” dhe “të humbura” të përcaktuara në rregulloren nr. 62/2011 “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, e ndryshuar. Llogaritja klasifikimit të kredisë me probleme është në përputhje me metodologjinë e FMN-së, ku si kriter për të përcaktuar një kredi si “me probleme”, nuk është vetëm numri i ditëve të vonuara (90 ditë), por edhe gjendja financiare e huamarrësit. Nga ana tjetër, ky raport devijon nga metodologjia, pasi përfaqëson një tregues të llogaritur vetëm për portofolin e kredisë së akorduar korporatave jofinanciare (biznes), individëve dhe qeverisë, duke lënë jashtë kreditë ndërbankare dhe kreditë dhënë institucioneve të tjera financiare. Pra, Banka e Shqipërisë ndjek një qasje shumë konservatore dhe prudeniale në analizën dhe vlerësimin e rrezikut të kredisë. Treguesi është gjerësisht i përdorur në analizat e Bankës së Shqipërisë dhe llogaritet me frekuencë mujore.

1005 Shpërndarja sektoriale e kredisë. Ky tregues përlllogaritet duke përdorur tepicën në kredi të secilit prej sektorëve institucionalë ndaj totalit të kredive bruto. Treguesi është raport i cilësisë së aktiveve dhe jep informacion lidhur me shpërndarjen e kredive (duke përfshirë edhe kreditë me probleme, si dhe pa zbritur rezervat për provigjionim për humbjet nga kreditë) në sektorët rezidentë dhe jorezidentë. Mungesa e diversifikimit sektorial në portofolin e kredisë sinjalizon për ekzistencë dobësisht potenciale në sistemin financiar.

PËRFITUESHMËRIA

1006 Kthimi nga aktivet (ROA). Kthimi nga aktivet synon të vlerësojë rentabilitetin në raport me kapitalin total brenda një periudhe kontabël për qëllime krahasimi. Treguesi përlllogaritet si raport i fitimit të vitit financiar (para tatimit dhe zërave të jashtëzakonshëm) ndaj mesatares së bilancit (aktiveve) të bankave. Fitimi për vitin financiar i nënshtrohet një përlllogaritjeje të mëtejshme në pasqyrën fitime/humbje të bankave (kthimi në baza vjetore), gjithashtu, aktivi mesatar i sistemit bankar llogaritet në bazë të statistikave mujore të bilancit të bankave.

1007 Kthimi nga kapitali (ROE). Kthimi nga kapitali kap normën e remunerimit të kapitalit aksionar brenda një periudhe kontabël. Raporti duhet të interpretohet në kombinim me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit – pasi një raport i lartë mund të tregojë përfitueshmëri të lartë dhe/ose shkallë të ulët kapitalizimi, dhe një raport i ulët mund të tregojë përfitueshmëri të ulët dhe/ose kapitalizim të lartë. Treguesi përlllogaritet si raport i fitimit të vitit financiar ndaj vlerës mesatare të kapitalit aksionar gjatë të njëjtës periudhë. Fitimi për vitin financiar i nënshtrohet një përlllogaritjeje të mëtejshme të pasqyrës fitime/humbje të bankave (në baza vjetore). Kapitali mesatar i referohet nivelit të mesatarizuar gjatë vitit të kapitalit aksionar, që përfshin: kapitalin e paguar, aksionet, diferencat e rivlerësimit, fitimet e pashpërndara, si dhe fitimin ose humbjen e vitit aktual. Devijimet nga metodologjia e FMN-së lindin për shkak se në llogaritjen e këtij treguesi përdoret fitimi neto pas zërave të jashtëzakonshëm dhe taksave (guida rekomandon përdorimin e fitimit para tatimit dhe zërave të jashtëzakonshëm), si dhe fitimit nuk i janë zbritur interesat e përlllogaritura për kreditë me probleme dhe veprimet në proces, megjithatë ndikimi i këtyre të fundit nuk është i rëndësishëm.

1008 Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto. Treguesi mat peshën relative të të ardhurave neto nga interesat – interesat të fituara minus shpenzimet për interesa - ndaj të ardhurave bruto. “Të ardhurat



bruto" llogariten si shuma e rezultatit neto nga interesat (marzhi neto i interesave) dhe rezultatit neto nga veprimtaritë e tjera (të cilat përgjithësisht përfshijnë të ardhura minus shpenzime nga: komisionet, qiratë, këmbimi valutor dhe operacione të tjera bankare). Llogaritja e treguesit nuk është plotësisht në përputhje me metodologjinë e FMN-së, pasi të dy zërave nuk u janë zbritur interesat e përlogaritura për kreditë me probleme dhe veprimet në proces, megjithatë ndikimi i këtyre të fundit nuk është i rëndësishëm. Ky tregues përdoret gjerësisht në analizat e Bankës së Shqipërisë.

1009 Shpenzime jo-interesi ndaj të ardhurave bruto. Treguesi mat efikasitetin e përdorimit të burimeve nga bankat dhe përlogaritet si raport i shpenzimeve administrative ndaj të ardhurave bruto. Shpenzimet jo-interesi përfshijnë të gjitha shpenzimet përveç atyre të interesit, përfshirë tarifat dhe komisionet. Ato janë të lidhura me aktivitetin e përgjithshëm të bankës dhe përfshijnë shpenzime si: të personelit, mirëmbajtjeje, qira dhe shpenzime të tjera veprimtarie. Të ardhurat bruto përfshijnë: të ardhurat neto nga interesat, të ardhurat nga tarifat dhe komisionet, nga veprimtaria me instrumente financiare, etj. dhe të ardhura të tjera të veprimtarisë. Llogaritja e treguesit nuk është plotësisht në përputhje me metodologjinë e FMN-së, pasi nuk zbriten interesat e përlogaritura për kreditë me probleme dhe veprimet në proces, megjithatë ndikimi i këtyre të fundit nuk është i rëndësishëm.

LIKUIDITETI

1010 Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve (shkalla e aktiveve likuide). Ky tregues përcjell informacion mbi përmbushjen e kërkesave për likuiditet për para në dorë (cash) ose mjete menjëherë të konvertueshme në cash, për t'u bërë ballë situatave të parashikuara dhe të paparashikuara. Treguesi llogaritet si raport i aktiveve likuide, të përcaktuara si të tilla nga rregullatori në kërkesat për likuiditet - me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 71 / 2009, i ndryshuar "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit", neni 19 pika 4, – ndaj totalit të aktiveve. Llogaritja e këtij treguesi nuk është plotësisht në përputhje me metodologjinë e FMN-së, duke marrë parasysh maturitetin e mbetur të kredive dhënë nga bankat - qasja e BSh-së është më e kujdesshme dhe konsideron vetëm kreditë me maturitet të mbetur njëjavor, në vend të huave të pagueshme brenda 3 muajve, sikundër i konsideron metodologjia e FMN-së. Gjithashtu, në llogaritjen e aktiveve likuide, Banka e Shqipërisë përdor metodën e matjes së gjerë të aktiveve likuide, duke përfshirë edhe pozicionet ndërbankare me institucionet rezidente dhe jorezidente. Përfshirja e pozicioneve ndërbankare pranohet nga udhëzuesi i FSI-ve, por rekomandohet përdorimi i metodës së matjes bazë të aktiveve likuide, e cila përjashton letrat me vlerë të borxhit.

1011 Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra. Ky tregues synon të evidentojë mospërputhjen e likuiditetit mes aktiveve dhe detyrimeve, dhe ofron një panoramë të shkallës në të cilën bankat do të mund të përballonin një tërheqje afatshkurtrë të fondeve, pa u ndeshur me probleme të likuiditetit. Treguesi përfaqëson raportin e aktiveve likuide (në dispozicion për të mbuluar detyrimet) ndaj detyrimeve afatshkurtra. Aktivitet likuide përcaktohen në pikën 4 të nenit 19 të rregullores nr.71/2009 "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit", e ndryshuar. Detyrimet afatshkurtra përfshijnë të gjitha detyrimet me maturitet të mbetur deri në 1 vit, duke iu bashkangjitur letrave me vlerë të Qeverisë të shitura në përputhje me marrëveshjen e riblerjes dhe depozitave nga palët e treta të vendosura si kolateral/garanci, në bazë të marrëveshjes së nënshkruar me bankën. Llogaritja e këtij treguesi nuk është plotësisht në përputhje me metodologjinë e FMN-së, duke marrë parasysh maturitetin e mbetur të kredive dhënë nga bankat - qasja e BSH-së është më e kujdesshme dhe konsideron vetëm kreditë me maturitet të mbetur njëjavor, në vend të huave të pagueshme brenda 3 muajve, sikundër i konsideron metodologjia e FMN-së. Ndërkohë, për detyrimet afatshkurtra, metodologjia e FMN-së përfshin të



gjitha detyrimet dhe pozicionin neto në derivativët financiarë (aktive minus detyrime). Gjithashtu, sipas FMN-së, maturiteti "afatshkurtër" duhet të përcaktohet në bazë të maturitetit të mbetur dhe jo atij kontraktual. Në analizat e Bankës së Shqipërisë, ky tregues përdoret gjerësisht dhe merr për bazë aktivet likuide në total (metoda e gjerë e matjes) në të cilën përfshihen edhe pozicionet ndërbankare me institucionet rezidente dhe jorezidente. Përfshirja e pozicioneve ndërbankare pranohet nga udhëzuesi i FSI-ve, por rekomandohet përdorimi i metodës së matjes bazë të aktiveve likuide, e cila përjashton letrat me vlerë të borxhit.

RREZIKU I TREGUT

I012 Pozicioni i hapur valutore ndaj kapitalit. Ky tregues ka për qëllim të identifikojë ekspozimet e bankave ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, në raport me kapitalin. Ai mat mospërputhjen e aktiveve dhe detyrimeve në valutë, për të vlerësuar dobësitë ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Pozicionet e hapura valutore përcaktohen në nenin 5 të rregullores nr.48/2010 "Për pozicionet e hapura valutore". Në analiza të ndryshme treguesi ndeshet shpesh si raport i pozicioneve neto në monedhë të huaj ndaj kapitalit rregullator, kapitalit bazë dhe kapitalit aksionar, në raporte të veçanta.


TREGUES INKURAJUES PËR BANKAT

Grupi i treguesve shtesë mundëson një pasqyrë plotësuese të situatës financiare të sektorit bankar përtej treguesve kryesorë.

I013 Kapitali ndaj aktiveve (raporti i kapitalit). Ky tregues jep informacion mbi masën në të cilën aktivet janë të financuara nga fondet e veta të kapitalit dhe është plotësues i treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar. Gjithashtu, raporti mat shkallën e levës financiare. Llogaritja e këtij treguesi është plotësisht në përputhje me metodologjinë e FMN-së. Treguesi përdoret gjerësisht në analizat e Bankës së Shqipërisë, i shprehur në tre raporte: kapitali bazë ndaj totalit të aktiveve; kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve; dhe kapitali aksionar ndaj totalit të aktiveve, si tregues plotësues të Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (RMK).

I014 Raporti i ekspozimeve të mëdha ndaj kapitalit. Ky tregues synon të identifikojë dobësitë që vijnë nga përqendrimi i rrezikut të kredisë. Treguesi paraqet raportin e ekspozimeve të mëdha ndaj kapitalit rregullator. "Ekspozimet e mëdha", siç përcaktohen në rregulloren nr.10/2014 "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave", e ndryshuar, i referohen ekspozimit të bankës ndaj një personi ose grupi personash të lidhur mes tyre ose me bankën, në rastet kur vlera e tyre është e barabartë ose më e madhe se 10% e kapitalit rregullator të bankës. Gjithashtu, ekspozimi më i madh i lejuar ndaj bankës mëmë, filialit të bankës, apo filialeve të bankës mëmë, nuk mund të tejkalojë 25% të kapitalit rregullator dhe ekspozimi më i madh i lejuar ndaj një personi ose grupi personash të lidhur mes tyre ose me bankën nuk mund të tejkalojë 20% të kapitalit rregullator.

I015: Shpërndarja gjeografike e kredisë. Si klasifikime rajonale sugjerohen klasifikimi i përdorur nga World Economic Outlook i FMN-së. Ky tregues është një raport i cilësisë së aktivitetit, i cili monitoron rrezikun e kredisë të krijuar nga ekspozimi ndaj një vendi të veçantë (ose grup vendesh) dhe ndihmon në vlerësimin e impaktit të ngjarjeve të padëshirueshme në këto vende në sistemin financiar vendas. Treguesi shërben si matje e rrezikut të përqendrimit të bankave. Treguesi nuk hartohet nga Banka e Shqipërisë.



1016: Raporti i aktiveve në derivativë financiarë ndaj kapitalit. Ky tregues përlloritet si raporti i pozicioneve në aktiv në formën e derivate financiare (bruto) ndaj kapitalit. Ky tregues jep një vlerësim të përafërt të rrezikut të zëvendësimit të kontratave derivative me një vlerë tregu pozitive. Ky tregues është një raport i cilësisë së aktivitetit dhe synon të ofrojë një tregues të ekspozimit të bankave në derivateve financiare ndaj kapitalit. Treguesi nuk hartohet nga BSh.

1017: Raporti i detyrimeve në derivativë financiarë ndaj kapitalit. Ky tregues jep një vlerësim të përafërt të humbjeve të mundshme që rrjedhin nga kontratat derivative me një vlerë tregu negative. Treguesi nuk hartohet nga Banka e Shqipërisë.

1018 Të ardhura nga operacionet financiare ndaj të ardhurave bruto. Ky raport është një tregues i të ardhurave dhe përfitueshmërisë, i cili synon të vërë në dukje atë pjesë të të ardhurave që bankat gjenerojnë nga aktivitetet në tregjet financiare, duke përfshirë këmbimin e monedhës - pra, treguesi mat mbështetjen e bankave në aktivitetet e tregut për të gjeneruar fitime. Treguesi paraqet raportin e fitimit (ose humbjes) nga veprimet me instrumentet financiare, ndaj të ardhurave bruto. Të ardhurat bruto llogariten si shuma e të ardhurave neto nga interesat (marzhi i interesave) dhe të ardhurave nga veprimtaritë e tjera, para shpenzimeve për provigjionim.

1019 Shpenzime personeli ndaj shpenzimeve jo-interesi. Ky tregues është një indikator i të ardhurave dhe përfitueshmërisë. Ai paraqet raportin e shpenzimeve të personelit (shpërblimi total, dhënë nga banka në këmbim të punës së kryer nga punonjësit gjatë periudhës kontabël, në para në dorë "cash" apo në çfarëdo lloj forme tjetër), ndaj shpenzimeve jo-interesi (shpenzimet totale të veprimtarisë si shpjeguar në treguesin 1009). Raporti mat kostot e personelit si pjesë e kostove totale administrative dhe siguron një tregues efikasiteti në aktivitetin e bankës dhe sektorit bankar pasi një raport i lartë apo në rritje mund të dëmtojë përfitueshmërinë e bankës.

1020 Spread-i midis normës së interesit të kredisë dhe depozitave. Ky tregues është një indikator i të ardhurave dhe përfitueshmërisë së sektorit bankar. Ai mund të përdoret gjithashtu për një gjykim lidhur me konkurrencën brenda sektorit. Treguesi paraqet diferencën midis normave të interesit të kredisë së re dhe normave të interesit të depozitave të reja me afat. Spread-i është llogaritur nga të dhënat statistikore mbi normën e interesit, si diferencë e mesatares së ponderuar të normave të interesit për kredinë, në monedha dhe maturitete të ndryshme, dhe mesatares së ponderuar të normave të interesit të depozitave me afat, në monedha dhe maturitete të ndryshme.

1021 Spread-i ndërmjet normës më të lartë dhe më të ulët të interesit ndërbankar. Ky tregues mat diferencën mes normës më të lartë dhe më të ulët të interesit në tregun e brendshëm ndërbankar dhe është një matës i likuiditetit. Metodologjia e FMN-së rekomandon përlloraritje javore të këtij treguesi, duke përdorur normat në fund të periudhës për kredi brenda të njëjtit maturitet. Shkalla e dispersionit në normat ndërbankare të interesit është një tregues i dobishëm në gjykimin mbi ekzistencën e stresit për likuiditetin në sektorin bankar dhe/ose në banka të caktuara – një dispersion i lartë në normat ndërbankare mund të sinjalizojë faktin që disa banka mund të perceptohen si në vështirësi likuiditeti nga bankat e tjera.

1022 Raporti i depozitave të klientëve ndaj totalit të kredive (përfshirë kreditë ndërbankare). Ky tregues mund të zbulojë probleme të likuiditetit në sektor - një raport i ulët mund të zbulojë një situatë potenciale stresi likuiditeti të sektorit bankar, dhe ndoshta një humbje depozituesish, si edhe humbje të besimit të investitorëve në qëndrueshmërinë afatgjatë të sektorit bankar. Si matës i likuiditetit në



sektorin bankar dhe në banka të veçanta, treguesi krahason bazën “e qëndrueshme” të depozitave me totalin e kredive. Kur depozitat e qëndrueshme janë më të ulëta krahasuar me kredinë e dhënë, ekziston një varësi më e madhe për të mbuluar aktivet jolikuide në portofolet e bankave me fonde me luhatshmëri më të madhe. Ky tregues llogaritet si raport i depozitave të klientëve ndaj totalit të kredive (banka qendrore, qeveria qendrore, korporata të tjera financiare, korporata jofinanciare, sektorë të tjerë rezidentë dhe jorezidentë), pa iu zbritur provigjionet e krijuara për këto të fundit. Llogaritja e këtij treguesi është tërësisht në përputhje me metodologjinë e FMN-së. Treguesi është gjerësisht i përdorur në analizat e Bankës së Shqipërisë.

1023 Kredi në monedhë të huaj ndaj totalit të kredive. Ky tregues është një indikator i cilësisë së aktiveve, i cili mat madhësinë relative të kredisë në monedhë të huaj brenda totalit të kredisë dhe monitoron ekspozimet ndaj rrezikut të kredisë dhe rrezikut të kursit të këmbimit. Treguesi është i një rëndësie të veçantë nën fokusin e rrezikut të kredisë, pasi lidhet me aftësinë e huamarrësve lokalë për të shlyer detyrimet e tyre në monedhë të huaj, veçanërisht kur monedha vendase është në trend zhvlerësimi. Treguesi paraqet raportin e totalit të kredive dhënë klientëve në monedhë të huaj (pa zbritur vlerën e provigjionimit për këto kredi) ndaj totalit bruto të kredive (banka qendrore, qeveria qendrore, korporata të tjera financiare, korporata jofinanciare, sektorë të tjerë rezidentë dhe jorezidentë).


1024 Detyrime në monedhë të huaj ndaj totalit të detyrimeve. Ky tregues synon të masë rëndësinë relative të financimeve në monedhë të huaj ndaj detyrimeve në total. Madhësia e këtij raporti duhet të konsiderohet së bashku me vlerën e treguesit të mëparshëm (kredi në monedhë të huaj ndaj totalit të kredive). Një mbështetje e lartë në huamarrjen në monedhë të huaj, veçanërisht ndaj asaj me maturitet afatshkurtër, mund të sinjalizojë rrezikshmëri të shtuar dhe ekspozim të bankës ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit dhe financimit në monedhë të huaj. Treguesi paraqet raportin e detyrimeve në monedhë të huaj kundrejt institucioneve financiare dhe klientëve ndaj totalit të detyrimeve. Totali i detyrimeve përfshin totalin e borxhit plus vlerën neto të derivativëve financiarë, përjashtuar kapitalin dhe rezervën.

1025 Pozicioni i hapur (neto) në kapital ndaj kapitalit. Ky raport është një tregues i ndjeshmërisë ndaj rrezikut të tregut, i cili synon të identifikojë rrezikun e ekspozimit në kapital relativisht ndaj kapitalit - për bankat e sektorit.

TREGUES INKURAJUES PËR INSTITUCIONET E TJERA FINANCIARE

1026 Aktive të institucioneve të tjera financiare ndaj totalit të aktiveve të sistemit financiar. Treguesi vë në raport totalin e aktivitetit të institucioneve të tjera financiare (ndryshe nga korporatat depozituese) ndaj totalit të aktiveve të sistemit financiar. Ai mat rëndësinë relative të institucioneve të tjera financiare brenda sistemit financiar vendas. Raporti përdoret në analizat e Bankës së Shqipërisë dhe është i disponueshëm vetëm në frekuencë tremujore.

1027 Raporti i aktiveve të institucioneve të tjera financiare ndaj prodhimit të brendshëm bruto (PBB). Ky tregues përlogaritet duke përdorur aktivet e institucioneve të tjera financiare ndaj prodhimit të brendshëm bruto. Ai mat rëndësinë relative të institucioneve financiare në ekonomi. Treguesi është i disponueshëm vetëm në frekuencë tremujore.



TREGUES INKURAJUES PËR SHOQËRITË JOFINANCIARE (BIZNESET)

Shoqëritë jofinanciare janë klientët më të rëndësishëm (kredimarrës) të sektorit financiar. Nëse situata e tyre financiare përkeqësohet, aftësia e tyre paguese bie, çka nga ana tjetër mund të ketë një efekt të drejtpërdrejtë në situatën e institucioneve financiare. Të dhënat në dispozicion për shoqëritë jo financiare, ndryshe nga të dhënat për sektorin bankar, janë më pak të plota, kështu që duhen konsultuar burime të ndryshme informacioni. Treguesit e mëposhtëm japin informacion në lidhje me elasticitetin e sektorit ndaj goditjeve.

I028 Totali i borxhit ndaj kapitalit. Ky tregues i shëndetit financiar është një matës i levës financiare të shoqërive - masa në të cilën aktivitetet janë financuar nëpërmjet detyrimeve dhe jo nga fondet e veta. Ky tregues përllogaritet duke përdorur borxhin në numërues dhe kapitalin në emërues. Ai llogaritet duke përdorur kuadrin lokal të vlerësimit Borxhi është përcaktuar si shuma e papaguar e detyrimeve, të cilat kërkojnë pagesa principali dhe/ose interesa nga debitori në të ardhmen. Kapitali përllogaritet si totali i kapitalit dhe rezervave, që është diferenca midis totalit të aktiveve dhe detyrimeve. Ky tregues nuk hartohet nga Banka. Informacion bazë për llogaritjen e tij janë llogaritë financiare, të cilat në hartimin e të dhënave të sektorëve jofinanciarë shfrytëzojnë burime të ndryshme primare statistikore. Në këtë kontekst mbledhin të dhëna nga pala korresponduese dhe në rastin specifik statistika bankare.

I029 Kthimi nga kapitali. Ky tregues përllogaritet duke përdorur fitimin para tatimit në numërues dhe vlerën mesatare të kapitalit dhe rezervave, gjatë të njëjtës kohë, në emërues. Është një tregues që përdoret zakonisht për të analizuar efikasitetin e shoqërive jofinanciare në përdorimin e kapitalit. Në përllogaritjen e tij devijimet nga Guida mund të lindin nga përdorimi i rregullave kombëtare të kontabilitetit në përcaktimin dhe konsolidimin e fitimeve të shoqërive si dhe kapitalit të tyre (sipas Guidës rekomandohet të jetë në vlerësim tregu). Ky tregues nuk hartohet nga Banka.

I030 Fitimi ndaj shpenzimeve për interes dhe principal Ky tregues mat aftësinë e shoqërive jofinanciare për të mbuluar pagesat e borxhit (interesat dhe principalin). Ai shërben si një tregues i rrezikut që një shoqëri të mos jetë në gjendje të kryejë pagesat e kërkuara mbi borxhin e saj. Gjenerohet në terma të llogarive kombëtare dhe llogaritet duke vendosur të ardhurat neto para tatimit plus interesat e arkëtuara nga shoqëritë e tjera jofinanciare si numërues, dhe pagesat e shërbimit të borxhit në të njëjtën periudhë si emërues. Ky tregues nuk hartohet nga Banka.

I031 Ekspozimi neto në valutë ndaj kapitalit. Ky tregues mat rrezikun e ekspozimit në valutë të shoqërisë jofinanciare krahasuar me kapitalin e saj. Sa më e ekspozuar të jetë shoqëria ndaj rrezikut të valutës, aq më të mëdha janë efektet e një zhvlerësimi të monedhës vendase mbi shëndetin financiar të shoqërisë jofinanciare, dhe si rrjedhim mbi bankat. Ky tregues llogaritet duke përdorur ekspozimin neto në valutë për zërat e bilancit si numërues dhe kapitalin dhe rezervat si emërues. Ekspozimet neto në valutë janë të gjitha zërat e aktivitetit të bilancit në monedhë të huaj, minus të gjithë zërat në monedhë të huaj të detyrimeve, përfshirë interesat e përllogaritit. Ky tregues nuk përdoret nga Banka dhe është i vështirë të llogaritet për shkak të mungesës së të dhënave.

I032: Numri i procedurave të filluara për falimentime. Ky tregues është një e dhënë numerike lidhur me rastet e procedurave të falimentimit të nisura gjatë periudhës. Në kohë, treguesi mat tendencën e falimentimit dhe influencohet nga cilësia dhe natyra e kuadrit të brendshëm rregullator të falimentimit dhe legjisllacionit të lidhur me të. Treguesi nuk matet nga Banka.



TREGUES INKURAJUES PËR EKONOMINË FAMILJARE (INDIVIDËT)

Familjet ndikojë situatën e sektorit financiar drejtpërdrejt dhe në mënyrë indirekte; drejtpërdrejt përmes vendimit për të investuar kursimet e tyre apo për të marrë kredi, dhe indirekt përmes sjelljes për konsum, e cila nga ana tjetër, ndikon sektorin financiar përmes shoqërive jofinanciare.

1033: Raporti i borxhit ndaj PBB-së (borxhi i familjeve ndaj PBB-së). Ky tregues jep informacion lidhur me nivelin e borxhit në raport me prodhimin e brendshëm bruto. Numëruesi për këtë tregues mund të llogaritet bazuar në llogaritë financiare, të cilat mbledhin të dhëna nga shumë burime primare statistikore përkatëse për këtë kategori, si p.sh. informacion nga statistikat bankare. Emëruesi përllogaritet nga Instituti i Statistikave.

1034: Raporti i pagesave për shërbimin e borxhit ndaj të ardhurave (Shërbimi i borxhit dhe pagesat e principalit ndaj të ardhurave). Raporti i pagesave të shërbimit të borxhit ndaj të ardhurave (shërbimit të borxhit të familjeve dhe pagesat e principalit ndaj të ardhurave). Ky tregues mat aftësinë e individëve në drejtim të shërbimit të borxhit të tyre. Baza për hartimin e këtij treguesi janë pasqyrat e llogarive financiare dhe llogarive kombëtare.

TREGUES INKURAJUES MBI LIKUIDITETIN E TREGUT

Transaksionet e kapitalit mund të ekzekutohen pa probleme vetëm nëse ekziston një nivel i mjaftueshëm i likuiditetit në treg - domethënë për sa kohë është e mundur të gjesh një blerës apo një shitës për të gjithë produktet financiare pa ndikuar ndjeshëm çmimin e tregut.

1035: Diferenca mesatare midis normës së kërkuar dhe ofruar në tregun e letrave me vlerë. Ky tregues pasqyron situatën e likuiditetit në tregjet e letrave me vlerë. Diferenca nënkupton ndryshimin midis interesit më të lartë të kërkuar dhe interesit më të ulët të ofruar nga pjesëmarrësit e tregut në një moment të caktuar. Sa më e lartë të jetë diferenca aq më shumë perceptim rreziku dhe vështirësi likuiditeti kanë pjesëmarrësit dhe e anasjella. Kjo e dhënë sigurohet nga operacionet monetare në tregun primar, më konkretisht nga pjesëmarrja në ankandet e letrave me vlerë të qeverisë.

1036: Norma mesatare ditore e vëllimit të transaksioneve në tregun e letrave me vlerë. Ky tregues shpreh vëllimin e transaksioneve ditore në totalin e vëllimit të letrave me vlerë të emetuara. Ai mbështetet tek statistikat mbi transaksionet në tregun sekondar dhe llogaritet si raporti i vëllimit të transaksioneve ditore kundrejt vëllimit të totalit të letrave me vlerë të emetuara në treg (treg primar).

TREGUES INKURAJUES PËR TREGUN E PASURIVE TË PALUAJTSHME

Zhvillimet ciklike në tregjet e pasurive të paluajtshme janë të lidhura ngushtë me sjelljen e huadhënies në sektorin financiar. Një boom në tregun e pasurive të patundshme shpesh është paraprirë ose shoqërohet me një rritje të madhe në huadhënien për sektorin privat. Në të kundërt, një rënie në tregun e pasurive të paluajtshme shpesh shoqërohet nga një rënie e dukshme në kreditimin e këtij sektori. Për më tepër, kriza financiare në të kaluarën janë paraprirë shpesh nga një rënie e fortë në tregun e pasurive të paluajtshme.

1037 Çmimet e pasurisë së paluajtshme. Ky tregues mbulon zhvillimet në indeksin e çmimeve të banesave. Një rritje e shpejtë e çmimeve të pasurive të paluajtshme, e ndjekur nga një rënie e



menjëhershme ekonomike, mund të ndikojë ndjeshëm qëndrueshmërinë e sektorit bankar, për efektet që mbart në cilësinë e kredisë dhe vlerën e kolateralit. Indekset e çmimit të banesave (ose pasurive të paluajtshme) matin inflacionin apo deflacionin e çmimit të banesave dhe/ose pronave tregtare gjatë një periudhe kohore. Indekset përshkruajnë ndryshimin e çmimeve ndërmjet një periudhe të caktuar dhe një periudhe bazë, duke lejuar krahasimet e lëvizjeve të çmimeve në mes të periudhave kohore. Aktualisht, Banka e Shqipërisë harton Indeksin e Çmimit të Banesave për Tiranën (që prej vitit 2006); si dhe (duke filluar nga viti 2013) ka hartuar një indeks çmimesh të pasurive të paluajtshme - banesa dhe prona tregtare - në rang vendi.

1039 Kredi për pasuri të paluajtshme rezidenciale ndaj totalit të kredive. Ky tregues është një raport i cilësisë së aktiveve, që ka për qëllim të identifikojë ekspozimin e bankave drejt sektorit të pasurive të paluajtshme, me fokus huamarrjen e individëve. Treguesi matet si raport i kredive për banesa të individëve ndaj totalit të kredive. Një përqendrim i lartë i portofolit të kredisë në pasuri të paluajtshme (banesa) jep sinjale dobësie në sistemin financiar. Raporti përdoret në analizat e Bankës së Shqipërisë.

1040 Kredi për pasuri të paluajtshme tregtare ndaj totalit të kredive. Ky tregues hartohet duke përdorur kreditë e kolateralizuara me pasuri të paluajtshme tregtare, hua për kompanitë e ndërtimit dhe hua për kompanitë me aktivitete në tregun e pasurive të paluajtshme (shërbime lidhur me tregun e pasurive të paluajtshme, p.sh agjenci imobiliare) ndaj totalit të kredive. Raporti është një tregues i cilësisë së aktiveve, që mat ekspozimin e bankës ndaj tregut të pasurive të paluajtshme dhe mbart të njëjtin rrezik ndaj ekspozimeve të larta si në treguesin 1039. Raporti përdoret në analizat e Bankës së Shqipërisë.



